

Hapet thirrja e II-të për aplikime për Shkollat Verore në Universitetin Radboud, Hollandë, për studentët PhD dhe stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, në kuadër të Programit Erasmus+ KA107.

Shkollat verore do të organizohen:

- 1 në muajin korrik 2019;
- 1 në muajin gusht 2019;

Për më shumë informacion mbi kurset e Shkollës Verore referohuni linkut:

<https://www.ru.nl/radboudsummerschool/application/erasmus/overview-courses-nominees-july-edition/>

<https://www.ru.nl/radboudsummerschool/application/erasmus/overview-courses-nominees-august-edition/>

Pjesëmarrja në këto Shkolla përban një kosto të përcaktuar, e cila do të zbritet nga granti Erasmus+. Për më shumë informacion mbi kompensimin referohuni linkut:

<https://www.ru.nl/radboudsummerschool/application/erasmus/information-erasmus-scholarships/>

Dokumentacioni për aplikim për studentët Ph.D.:

- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Letër motivimi;
- Certifikatë e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo një mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);

Dokumentacioni për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë:

- Kopje e pasaportës;
- Vërtetim punësimi;
- Letër motivimi;
- Certifikatë e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo një mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);

Afati për aplikim: 05 Prill 2019

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF dhe të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!